

## **Raport për rezultatet e konsultimeve publike**

### **1. Titulli i draft aktit**

Projektligji “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 7.12.2022 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: (1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; 3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë) ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: [merita.bundo@kryeministria.al](mailto:merita.bundo@kryeministria.al).

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 10.1.2023.

Projektligji “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” si dhe relacioni përkatës u publikuan në, [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al).

### **3. Metoda e konsultimit**

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar vetëm procesit të konsultimit publik, nëpërmjet publikimit të tij në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 7.12.2022 deri në datën 7.1.2023.

### **4. Palët e interesit të përfshira**

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nëpërmjet sistemit e-akte institucionet të cilat kanë përcjellë komente dhe sugjerime (elektronikisht) janë institucionet, si më poshtë vijon:

1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
2. Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP)
4. Ministria e Drejtësisë (MD)
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)

Nga publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, kanë dërguar komente dhe sygjerime (elektronikisht dhe me shkresë) institucionet si vijojnë:

6. Paysera Albania shpk
7. Shoqata Shqiptare e Bankave
8. VELOXPAY shpk
9. IUTE CREDIT SH. A
10. RUBICON

Projektligji është propozuar nga Kryeministri dhe është hartuar me kontributin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), si dhe është bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

#### **1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara**

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;  
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;  
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<b>Çështja e adresuar</b>	<b>Komenti</b>	<b>Palët e interesuara</b>	<b>Vendimi</b>	<b>Justifikimi</b>
<b>I. Mbi përmbajtjen e nenit 3 Përkufizimet</b>	Sipas projektligjit dhe relacionit shpjegues, projektligji është përafëruar plotësisht me Rregulloren (BE) nr.910/2014, megjithatë rezulton se përkufizimet e dhëna në nenin 3 të projektligjit, nuk përputhen me përkufizimet e dhëna në nenin 3 të Rregullores 910/2014, si p.sh.	MD	Pranuar pjesërisht	Përkufizimet janë sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren eIDAS, i vetmi riformulim që është bërë i referohet të <i>dhënave të identifikimit personal. Autentifikim</i>

	<p>“autentifikimi”, “ofruesi i shërbimit të besuar”, “skema e identifikimit elektronik”, “të dhënat e identifikimit personal” etj. Nisur nga rëndësia që kanë përkufizimet për hartimin e zbatimin e dispozitave vijuese, si dhe për të shmangur çdo paqartësi, të rishikohen këto përkufizime në raport me dispozitat vijuese të projektligjit.</p>		<p><u>Rregullorja</u>: “është një proces elektronik që mundëson identifikimin elektronik të një personi fizik ose juridik, apo konfirmimin e origjinës dhe integritetin e të dhënave në formë elektronike”  <u>Ligji</u>: “është një proces elektronik që mundëson identifikimin elektronik të sigurt të një personi fizik ose juridik; ose konfirmimin e origjinës dhe integritetin e të dhënave në formë elektronike”.  Përkufizimi është i njëjtë, vetëm se në ligjin tone është përdorur termi identifikim elektronik i sigurt dhe jo vetëm identifikim elektronik.  <b><i>Ofrues I shërbimit të besuar</i></b>  <u>Rregullorja</u>: është personi fizik ose juridik, i cili ofron një apo më shumë shërbime të besuara si ofrues i kualifikuar ose jo i kualifikuar i shërbimeve të besuara;  <u>Ligji</u>: “është person fizik ose juridik i cili ofron një ose më shumë</p>
--	--	--	--

				<p>shërbime të besuara jo të kualifikuara” Ligji ynë përcakton që shërbime të besuara të kualifikuara i ofrojnë vetëm ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara. <b>Skema e identifikimit elektronik</b> <u>Rregullorja</u>: “është një sistem për identifikimin elektronik, sipas të cilës mjetet e identifikimit elektronik ju lëshohen personave fizikë ose juridikë, ose personave fizikë që përfaqësojnë personat juridikë” <u>Ligji</u>: “është tërësia e mjeteve dhe sistemeve të identifikimit elektronik, të nevojshme për të kryer procesin e identifikimit elektronik të sigurt” Në përmbajtje është po e njëjta gjë.</p>
	<p><u>Neni 3</u> Në këtë nen janë disa përkufizime të ngjashme si psh: Certifikatë për nënshkrim elektronik; Certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Rregullorja eIDAS i përcakton si përkufizime dhe reflektimi në projektligj është bërë sipas rregullores. Nga përkufizimet e</p>

	<p>elektronik; Certifikatë për vulë elektronike; Certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike; Certifikatë për autentifikim faqesh internet; Certifikatë e kualifikuar për autentifikim faqesh internet, Nënshkrim elektronik, Nënshkrimet elektronike të kualifikuara, etj.</p> <p>Cili është dallimi i tyre në praktikë? Nga përkufizimet kuptohet se një pjesë e tyre lëshohen nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Për grupin tjetër nuk është përcaktuar se nga cili institucion lëshohen dhe se kur mund të përdoren. Nuk është e qartë nga përkufizimet, si dhe duhet të sqarohet institucioni që e lëshon.</p>			<p>dhëna në nenin 3 të projektligjit bëhet qartë dallimi i secilit koncept, pasi certifikatat e kualifikuara kanë të përcaktuar në ligj lidhur kriteret që duhet të përmbushin. Lidhur se kush i lëshon janë Ofruesit e Shërbimit të Besuar</p>
--	--	--	--	---

	<p><u>Neni 3 pika 9:</u>  “Dokument elektronik” është çdo material i ruajtur në formë elektronike, në veçanti tekst apo regjistrim audio, vizual apo audio-vizual, që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligji,”  Theksojmë se është e nevojshme që pika e mësipërme të riformulohet si vijon:  “Dokument elektronik” është çdo material i krijuar, i dërguar, i marrë, i transmetuar ose i ruajtur në formë elektronike, në veçanti tekst apo regjistrim audio, vizual apo audio-vizual, që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligji;”</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Është bërë riformulimi i pikës: “Dokument elektronik” është çdo material i krijuar, i dërguar, i marrë, i transmetuar ose i ruajtur në formë elektronike, në veçanti tekst apo regjistrim audio, vizual apo audio-vizual, që plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin nr.10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar. Ligj i cili nuk është shfuqizuar.</p>
	<p><u>Pika 11 e nenit 3:</u>  “Identifikim elektronik i sigurt” është procesi i identifikimit elektronik i bazuar në një certifikatë elektronike për identifikim elektronik të sigurt, që është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar dhe plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj; Projektligji nuk përmban asnjë shpjegim /përkufizim për “certifikatën elektronike për identifikim elektronik të sigurt”. Për më tepër, ajo që është gjithashtu e rëndësishme, Rregullorja e BE-së 910/2014 nuk ofron një përkufizim të</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Projektligji ynë njeh vetëm identifikimin elektronik të sigurt prandaj është sqaruar si koncept tek përkufizimet. Pavarësisht se Rregullorja eIDAS nuk e përmend nuk do të thotë që të ndalon ta përdorësh. Rregullorja ofron konceptin e “identifikim elektronik” ndërsa termi i përdorur nga ne është “identifikim elektronik i sigurt”. Rregullorja: ‘identifikimi elektronik’ është</p>

	<p>"identifikimit elektronik të sigurt" ose konceptin e "certifikatës elektronike për identifikim elektronik të sigurt". Prandaj, për të shmangur çdo konfuzion, sugjerojmë që përkufizimi i "identifikimit elektronik të sigurt" të hiqet nga projektligji.</p>		<p>procesi i identifikimit elektronik të një personi fizik dhe verifikimi i vërtetësisë së identitetit të tij, nëpërmjet përdorimit të të dhënave të identitetit personal në formë elektronike, të cilat përfaqësojnë në mënyrë unike personin fizik apo juridik, ose personin fizik që përfaqëson personin juridik. Projektligji: është procesi i identifikimit elektronik i bazuar në një certifikatë elektronike për identifikim elektronik të sigurt, që është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar dhe plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Pra në përmbajtje janë e njëjta gjë verifikimi i identitetit të aplikuesit, vetëm se në ligjin tonë përmendet koncepti i "sigurt" lidhur me ofrimin apo garantimin e besueshmërisë së këtij procesi.</p>
--	--	--	---

	<p><u>Neni 3, Pika 21:</u>  “Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit” është një organ kompetent i akredituar për të kryer vlerësimet dhe testimet e konformitetit të veprimtarisë së një Ofruesi të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Koment: Lutemi nëse mund të ketë sqarime të mëtejshme nëse organizmi do të jetë nga Sektori Publik apo Privat? Nëse është privat, mungesa e një operatori të tillë mund të çojë në bllokim të situatës deri në akreditimin e një operatori privat.</p>	<p>VELOXPA Y SHPK  IUTE CREDIT SH. A  RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Ne piken 1 te nenit 48 te projektligjit përcaktohet se: “1. Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit është një person fizik ose juridik, kombëtar i akredituar nga Autoriteti Përgjegjës për Akreditimin në Republikën e Shqipërisë, ose ndërkombëtar pjesë e listës së besuar të vendeve të Bashkimit Evropian. Pra nuk është i kufizuar në privat, mjafton të plotësoje kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu duke qenë se aktualisht nuk ka të tillë në Republikën e Shqipërisë OTK mund të jetë edhe ndërkombëtar, duke e rregulluar kështu situatën kur nuk ka organizma të tillë vendas.</p>
	<p><u>Neni 3, Pika 38</u>  “Transaksion elektronik” është blerja apo shitja e mallrave apo shërbimeve, qofshin këto ndërmjet bizneseve, qytetarëve, institucioneve qeveritare apo</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Është bërë riformulimi: “Transaksion elektronik” është blerja, shitja e mallrave apo shërbimeve, qofshin këto ndërmjet</p>



	<p>organizatave të tjera private, të kryera nëpërmjet rrjeteve kompjuterike.</p> <p>Komenti: Transaksioni elektronik nuk ka përse të kufizohet vetëm me shit-blerjen, transaksion është çdo lloj marrëdhënieje biznesi apo tregtare apo shërbimesh publike apo private e kryer nëpërmjet rrjeteve elektronike/kompjuterike.</p>			<p>personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë, të kryera nëpërmjet rrjeteve kompjuterike.</p> <p>Referenca është bërë në përkufizimin e dhënë nga Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD).</p>
	<p>Përkufizimi i termit “organ publik”, të riformulohet në përputhje me përkufizimin e dhënë nga KPA.</p>	MD	Refuzuar	<p>Ky përkufizim është bërë në përputhje me fushën e zbatimit të këtij ligji.</p>
<p><b>II. Shtim përkufizimesh</b></p>	<p><u>Lidhur me nenin 3 “Përkufizimet”, në pikën 30 të këtij projektligji jepet përkufizimi i “Pseudonimit”.</u></p> <p>Duke qenë se ky term përmendet në mënyrë specifike në projektligj, Zyra e Komisionerit vlerëson se në përputhje edhe me legjislacionin e ri që pritët të miratohet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, që synon përafrimin me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale/GDPR, të përfshihet edhe një përkufizim me procesin e pseudonimizimit si një masë tekniko organizative që garanton sigurinë e të dhënave personale,</p>	KDIMDHP	Pranuar	<p>Reflektuar</p>

	duke i bërë referencë legjislacionit specifik të fushës, dhe më konkretisht : “Pseudonimizim” sipas këtij ligji ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.			
	Në përmbajtje të projektligjit është përdorur termi “ <i>incident i sigurisë</i> ”, i cili nuk është përkufizuar në <u>nenin 3</u> dhe është e paqartë nëse përfshin shkeljet e sigurisë dhe humbjen e integritetit.	MD	Pranuar	Neni 3 pika 13 : “Incident i sigurisë” sipas këtij ligji ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike.
<b>III.Terminologji a juridike</b>	Në përputhje me terminologjinë e përdorur nga KPA, fjalët “aplikant” dhe “aplikues” të zëvendësohen me fjalën “kërkues”	MD	Pranuar	Reflektuar në nenet përkatëse të projektligjit
	Termi “revokim” në të gjithë përmbajtjen e projektligjit, të zëvendësohet me termat “shfuqizim” ose “anulim” në përputhje me terminologjinë dhe parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Kudo në përmbajtjen e projektligjit fjalët, “pa vonesë”, të zëvendësohen me fjalët “sa më shpejt të jetë e mundur, por...”, në përputhje me	MD	Pranuar	Reflektuar

	terminologjinë e përdorur nga KPA.			
	Fjalët “institucionin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale” të zëvendësohen me emërtimin “Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.	MD	Refuzuar	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përgjigjen e kthyer, i është referuar emërtimit <i>autoritet përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale</i> , i cili është referuar në projektligj.
<b>IV.Teknika legjislative</b>	Në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 9 udhëzimit nr.6, datë 29.4.2022, të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative” (në vijimi udhëzimi nr. 6/2022), përpara dispozitës së qëllimit, të shtohet edhe dispozita mbi objektin e ligjit.	MD	Pranuar	Reflektuar
	Neni 1: fjalët “kuadrit të nevojshëm ligjor” zëvendësohet me “rregullave”	MD	Pranuar	Reflektuar
	Në nenin 2, fjala “operojnë” në pikën 1, të zëvendësohet me fjalët “ushtrojnë veprimtarinë”, dhe fjala “kombëtar” në pikën 3, të zëvendësohet me fjalën “shqiptar”	MD	Pranuar	Reflektuar
	Në përputhje me pikën 3 të nenit 28 të udhëzimit nr. 6/2022, të shmanget përdorimi i lidhëzës së përbërë “dhe/ose”, si dhe në	MD	Pranuar	Reflektuar

	nenin 23, në pikën 2, të nenit 49, në pikën 2, të nenit 50, shenja e fraksionit (/) të zëvendësohet, sipas rastit, me lidhëzat “dhe” apo “ose”.			
	Në pikën 15, të nenit 3, në fjalët “mjetit së identifikimit” të zëvendësohet me fjalët “mjetit të identifikimit”.	MD	Pranuar	Reflektuar
	Në përputhje me nenet 15 dhe 16, të udhëzimit nr. 6/2022, fjala “konformitetit” në pikën 21, të nenit 3, të zëvendësohet me fjalën “përputhshmërisë”, fjalët “komponentët” në pikën 28 dhe “konsiston” në pikën 32 të nenit 3, “gjenerimi”, në pikën 3, të nenit 27, “kompromentuar” në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 30, “relevante” në pikën 1, të nenit 30, “domain”, në nenin 43, si dhe fjala “integritet” në përmbajtje të të gjithë projektligjit, të zëvendësohen me fjalët më të përshtatshme në gjuhën shqipe.	MD	Refuzuar	Nuk janë reflektuar pasi janë terma specifike që përdoren për këtë fushë dhe nuk mund të gjenden fjalë më të përshtatshme në gjuhën shqipe.
	Fjalët “bizneseve, qytetarëve, institucioneve publike apo organizatave të tjera private” në pikën 39, të nenit 3, të zëvendësohen me fjalët “personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë”.	MD	Pranuar	Reflektuar
	Të rishikohet <u>pika 2, e nenit 4</u> , në raport me pikën 2, të nenit 5 të Rregullores, si dhe në	MD	Pranuar pjesërisht	Lidhur me rishikimin e pikes 2 të nenit 4 është bërë reflektimi i

	<p>raport me ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, në kushtet kur ky ligj nuk rregullon përdorimin e pseudonimit. Gjithashtu, për efekt të qartësisë të rishikohet përdorimi i fjalëve “brenda kornizës së një transaksioni elektronik”.</p>			<p>komentit të ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave personale, ku është shtuar përkufizimi <i>pseudonimizim</i>, duke qenë se edhe legjislacioni i ri që pritet të miratohet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale i përmban dhe i rregullon këto koncepte. Gjithashtu është bërë referenca në legjislacionin specifik të fushës. Përdorimi i fjalëve “brenda kornizës së një transaksioni elektronik” është rishikuar.</p>
	<p><u>Neni 4 pika 2</u>  “Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale”  A lejon legjislacioni shqiptar përdorimin e “pseudonimeve”? Më konkretisht, a e lejon ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përdorimin e pseudonimeve?</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>		<p>Kjo pikë është riformuluar sipas sugjerimeve të ardhura nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku kanë sugjeruar shtimin e një koncepti tjetër atë të “pseudonimizimit” referuar ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale konform legjislacionit të BE.</p>
	<p><u>Pika 2, e nenit 5, pikat 5 dhe 8 të nenit 17, pika</u></p>	<p>MD</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Reflektuar</p>

	<p><u>3, e nenit 45, si dhe neni 53, të rishikohen në përputhje me nenin 25, të udhëzimit nr. 6/2022.</u></p>			
	<p><u>Në pikën 16, të nenit 3, në fjalët “person fizik/individ” të hiqet fjala “individ”.</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Në pikën 23, të nenit 3, fjalët “organ publik ose privat” të zëvendësohen me fjalët “person fizik ose juridik, publik apo privat”.</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Në pikën 1, në nenit 8, fjalët “garantojnë siguri ekuivalente ndaj pranisë fizike”, si dhe në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 17, fjalët “ofrojnë një siguri ekuivalente në aspektin e besueshmërisë ndaj pranisë fizike” të zëvendësohen me fjalët “garantojnë siguri të njëjtë sikurse paraqitja fizike”. Të hiqet fjala “fizik”, në pikën 3, të të njëjtit nen.</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Në pikën 1, të nenit 10, fjalët “institucione publike dhe private” të zëvendësohen me fjalët “persona fizik dhe juridikë, publikë apo privatë”. Pika 2 të riformulohet si vijon: “Skemat kombëtare të identifikimit elektronik ndërveprojnë”. Në pikën 3, fjalët “zbatimin e parimit të privatësisë që nga projektimi (privacy by design)” të zëvendësohen me fjalët “garanton mbrojtjen e</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar

	<p>të dhënave personale në projektim”. Në pikën 4, të rishikohet përdorimi i fjalëve “brenda juridiksionit të tij” dhe nëse kuptimi lidhet me territorin në të cilat merret masat, këto fjalë të zëvendësohen me fjalët “brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”.</p>			
	<p><u>Paragrafi i dytë, i pikës 1, të nenit 13, paragrafi i dytë, i pikës 2, të nenit 17 dhe paragrafi i dytë, i pikës 4, të nenit 17, si dhe çdo paragraf tjetër që të numërohet.</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p>Në pikën 2, të nenit 13, të hiqet shkronja “c” pasi ristrukturimi nuk përbën shkak për lirimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKCESK, duke qenë se një pozicion i tillë do të ekzistojë pavarësisht strukturimit të institucionit. <u>Shkronja “a” e pikës 3, përbën shkak për lirimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe si pasojë, ajo duhet të parashikohet në pikën 2, të nenit 13.</u></p>	MD	Pranuar pjesërisht	<p>Reflektuar komenti lidhur me ristrukturimin, ndërsa shkronja “a” e pikës 3 të nenit 13 “<i>dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje</i>” vlerësojmë se përbën shkak për shkarkimin e tij.</p>
	<p>Të rishikohet <u>shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 16, pasi është e paqartë se çfarë nënkuptohet me fjalët “nuk ka besueshmërinë e nevojshme”.</u></p>	MD	Refuzuar	<p>Është term i përdorur edhe në ligjin aktual. Nënkupton që OKSHB nuk është me i besueshëm për të ushtruar veprimtarinë e tij si i tillë referuar kushteve ligjore, teknike, financiare që duhet të</p>

				përmbushë. Këto elementë do të përcaktohen me akt nënligjor.
Të rishikohet <u>shkronja “ç” e pikës 1, të nenit 16</u> , pasi ajo nuk parashikohet nga neni 17 i Rregullores, si dhe nuk janë përcaktuar se cilat janë kriteret për të përcaktuar nëse një produkt është ose jo i përshtatshëm.	MD	Refuzuar	Rregullorja përcakton në nenin 24 përdorimin e sistemeve dhe produkteve të përshtatshme. Në ligj lidhur me përcaktimin se kur një produkt është i përshtatshëm ose jo do përcaktohen me akt nënligjor referuar kushteve dhe kriterëve që OKSHB duhet të përmbushë në ushtrimin e veprimtarisë së tij.	
<u>Neni 17</u> Sipas neneve 108 e vijues, të Kodit të Procedurave Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale është absolutisht i pavlefshëm dhe si tillë konsiderohet se nuk ekziston e duhet anuluar dhe jo shfuqizuar. Si pasojë, shkronja “a”, e pikës 4, e nenit 17, të vendoset si pikë me vete dhe për këtë pikë të parashikohet anulimi i aktit.	MD	Pranuar	Reflektuar	
<u>Neni 17 i projektligjit:</u> Sugjerojmë që ky nen të ndahet në dy nene të veçanta. Një të	Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)	Refuzuar	Titulli i nenit 17 është riformuluar “Lëshimi, pezullimi, anulimi	



	<p>përmbajë përcaktimet për lëshimin e certifikatave të kualifikuara. Tjetri të përmbaje përcaktimet për shfuqizimin, revokimin dhe pezullimin e certifikatave të kualifikuara.</p>			<p>dhe shfuqizimi i certifikatave të kualifikuara”, si veprime juridike që shoqërojnë njëra tjetër</p>
	<p><u>Në pikën 2 të nenit 17,</u> të shtohet dhe përcaktimi që informacioni për identifikimin e personit fizik/juridik verifikohet edhe nëpërmjet përdorimit të metodave të identifikimit të njohura në vendet e BE, si më poshtë: “d) duke përdorur metoda të tjera të identifikimit të njohura në vendet e Bashkimit Evropian, të cilat ofrojnë një siguri ekuivalente në aspektin e besueshmërisë ndaj pranisë fizike. Konfirmimi për sigurinë ekuivalente në këto raste konfirmohet nga Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit në shtetin e BE-se në të cilin është licencuar ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar.”</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Nuk shihet e nevojshme specifikimi i tyre në ligj. Gjithashtu në <u>nenin 8 pika 1</u> përcaktohet: “Identifikimi fillestar bëhet me paraqitjen fizike ose në distancë me metoda të tjera të identifikimit, që garantojnë siguri ekuivalente ndaj pranisë fizike të konfirmuar nga një Organizëm i Testimit dhe Konfirmimit, sipas standardeve evropiane, për këtë fushë”. Është përmendur.</p>
	<p><u>Në pikën 2, të nenit 17,</u> parashikohet se verifikimi kryhet nga vetë Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar ose nga një palë e tretë, por nuk janë përcaktuar rregullat</p>	<p>MD</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Palë e tretë i referohemi autoritetit regjistruar të OKSHB.Fjala “remotely” është hequr.</p>

	<p>mbi mënyrën e përzgjedhjes së palës së tretë dhe cila është marrëdhënia juridike që krijon pala e tretë me ofruesin. Të hiqet fjala “remotely” në shkronjën “b”.</p>			
	<p><u>Pika 3 e nenit 17 të projektligjit</u>: Po në rastet kur certifikata skadon? P.sh. nëse validiteti i certifikatës elektronike është 365 ditë, në ditën e 366 nëse klienti do të rinovoj certifikatën çfarë procedure duhet të ndiqet nga Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar edhe nga zotëruesi i certificates?</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Do të kryhet vetë nga OKSHB sipas procedurave të përcaktuara në ligj.</p>

	<p><u>Neni 17:</u> Për efekt të qartësisë së normës, të sqarohet se çfarë nënkupton paraqitja në sportelin elektronik të personit fizik, e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 2 të të njëjtit nen, si dhe si kryhet ajo. Paragrafi i dytë i pikës 2, të numërohet si pika 3, si dhe të përcaktohet se për cilat të dhëna duhet të njoftojë personi Ofruesin e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, duke qenë se kjo pikë nuk parashikon të dhëna konkrete.</p>	MD	Pranuar pjesërisht.	<p>Është bërë numërtimi. Sporteli elektronik është një term i përdorur lidhur me marrjen e shërbimeve online. Pra identifikimi i të dhënave për verifikimin e identitetit të aplikuesit online. Duke qenë se projektligji sjell risi edhe identifikimin në distancë apo me metoda të tjera të cilat garantojnë siguri të njëjtë me paraqitjen fizike, pra përveç paraqitjes fizike identifikimi do të mund të bëhet edhe në distancë (apo metoda të tjera që do përcaktohen me VKM), prandaj është përdorur <i>termi sportel elektronik</i>. Lidhur me paragrafin e 2 të pikës 2 është rinumërtuar dhe është riformuluar.</p>
	<p><u>Në pikën 4, të nenit 17,</u> të hiqet fjalia “Shfuqizimi nuk ka efekt prapaveprues.” pasi efekti i shfuqizimit të një akti është parashikuar në pikën 2, të nenit 113 të KPA.</p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p>Fjalja e dytë, <u>e pikës 5,</u> të hiqet duke qenë se pas</p>	MD	Pranuar	Reflektuar

	<p>përcaktimit të termit të saktë në përputhje me KPA sipas komentit të dhënë në pikën 3.3 të këtij mendimi, pra “shfuqizim” ose “anulim”, përcaktohen edhe efektet që do të shfuqizimi ose anulimi.</p>			
	<p>Për efekt të qartësisë së normës, në <u>pikën 7, të nenit 17</u>, fjalët “për periudhën e pezullimit”, të zëvendësohen me fjalët “gjatë periudhës së pezullimit”.</p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p>Për shkak të paqartësisë që krijohet për shkak të plotësimit të dy kushteve të ndryshme për fillimin e ofrimit të shërbimeve sipas <u>pikës 6, të nenit 19</u>, si dhe në përputhje me parashikimin e Rregullores së BE, të hiqet togfjalëshi “pas përfitimit të statusit të përmendur <u>në pikën 4 të këtij neni</u>, si dhe”.</p>	MD	Refuzuar	<p>I referohet atyre ofruesve të cilët nuk kanë marrë statusin të kualifikuar. Që këta ofrues të shërbimit të besuar të mundën të ofrojnë shërbime të besuara të kualifikuara duhet të bëjnë kërkesë tek Autoriteti. Vetëm me përfitimin e statusit mund të ofrojnë shërbime të tilla.</p>
	<p>Të rishikohet në tërësi <u>pika 1, e nenit 19</u> në përputhje me <u>pikën 1, të nenit 21</u> të Rregullores. Afati i përcaktuar në ligj nuk është përcaktuar në rregullore dhe për më tepër, kërkesa duhet të paraqitet përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë dhe jo pas fillimit të saj.</p>	MD	Refuzuar	<p>Rregullorja nuk përcakton afat por e specifikon për ofruesit që nuk kanë marrë statusin e kualifikuar të cilët duan të ofrojnë shërbime të besuara të kualifikuara. Gjithashtu pjesa e afatit është</p>

				vendosur për të lehtësuar procesin, duke qenë se ne njohim vetëm Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, pra vetëm ofruesit që kanë marrë statusin të kualifikuar mund të ofrojnë shërbime të besuara të kualifikuara.
	Në kushtet kur sipas formulimit aktual, <u>shkronja “ë” dhe shkronja “gj” e nenit 20</u> , parashikojnë të njëjtin detyrim për ofruesit e shërbimit, të rishikohet <u>shkronja “ë”, në përputhje me parashikimet e shkronjës “h”, të nenit 24, të Rregullores.</u> Ndërkohë, pas fjalëve “të regjistrojë” të shtohen fjalët “në regjistër”, fjala “relevant” të hiqet, si dhe fjalët “Një regjistër i tillë” të zëvendësohen me fjalën “Regjistri”.	MD	Pranuar	Reflektuar
	Në <u>pikën 1, të nenit 22</u> , fjalët “qëllimi i auditimit duhet të jetë” të zëvendësohen me fjalët “auditimi kryhet”. <u>Në pikën 2,</u> të po të njëjtit nen, fjalët “pa cenuar pikën 1,” të zëvendësohen me fjalët “pavarësisht parashikimeve të pikës 1”.	MD	Pranuar	Reflektuar

	Secila nga fjalitë e <u>nenit 23</u> , të ndahen pika të veçanta	MD	Pranuar	Reflektuar
	Të shmanget përdorimi i termit “e aplikueshme” në nën <u>paragrafin “i”</u> , të <u>shkronjës “b”</u> , të <u>pikës 1</u> , të <u>nenit 26</u> . <u>Shkronja “g”</u> , të riformulohet si vijon: “g) sipas rastit, një tregues të përshtatshëm që mundëson përpunimin automatik, që tregon se të dhënat për krijimin e një nënshkrimi elektronik lidhen me të dhënat e vlefshmërisë së tij dhe janë vendosur në pajisjen për krijimin e një nënshkrimi elektronik të kualifikuar”. I njëjti formulim të përdoret edhe në dispozitat e tjera të projektligjit që lidhen me këtë tregues.	MD	Pranuar	Reflektuar
	<u>Shkronja “c”</u> , e <u>pikës 1</u> , të <u>nenit 27</u> , nuk përbën një dispozitë të re, por është vazhdimi i dispozitës së parashikuar në shkronjën “c”. Të rishikohet renditja e shkronjave në këtë pikë, në përputhje me alfabetin shqip.	MD	Pranuar	Reflektuar
	Në <u>pikën 4</u> , të <u>nenit 27</u> , fjalët “pa rënë ndesh me shkronjën “ç””, të zëvendësohen me fjalët “pavarësisht parashikimeve të shkronjës “ç””, fjalët “të back-up (ruajtjes)” të zëvendësohen me fjalën “ruajtjeje”, si dhe fjalët	MD	Pranuar	Reflektuar

	<p>“dublikojnë” e “dublikuara” të zëvendësohen me fjalët “riprodhojnë” dhe “riprodhuara”.</p>			
	<p><u>Në pikën 1, të nenit 28</u> fjalët “organ publik ose privat”, si dhe kllapat e përdorura në këtë pikë të hiqen.</p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p>Të shmanget përdorimi i fjalëve “aty ku është e aplikueshme” në shkronjën “b”, të nenit 43.</p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Në pikën 1, të nenit 51,</u> fjalët “legjislacionit përkatës në fuqi” të zëvendësohen me fjalët “legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në kushtet kur shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i vendimeve kryhet sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, të hiqet <u>pika 3, e nenit 51.</u></p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Pika 1 e nenit 53,</u> të riformulohet si vijon: “Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr.107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar dhe ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar,” nëse nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, mbeten në fuqi deri në miratimin e</p>	MD	Pranuar	Reflektuar

	akteve nënligjore sipas nenit 52, të këtij ligji.”			
	Projektligji të hartohet në përputhje me strukturën e parashikuar në nenin 9 të udhëzimit nr.6/2022. Gjithashtu, të mbahet parasysh formatimi i tekstit sipas nenit 13 të këtij udhëzimi.	MD	Pranuar	Reflektuar
<b>V. Mbi fushën e veprimit të këtij projektligji</b>	<p><u>Neni 2 “Fusha e veprimit”</u>: “1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e besuara, për skemat e identifikimit elektronik, transaksionet elektronike si dhe për ofruesit e shërbimeve të besuara, të cilët operojnë në Republikën e Shqipërisë.”</p> <p>Në pikën 1 më lart duhet të shtohet një fjali që parashikon zbatimin e ligjit edhe për ofruesit e shërbimeve të besuara dhe ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara të cilët janë licencuar në një vend të Bashkimit Europian dhe veprojnë në baze të e-IDAS (Electronic Identification, Authentication and trust Services).</p> <p>Licenca e tyre duhet të kenë të njëjtën vlerë ligjore dhe provuese si dhe ofruesit që janë licencuar në Shqipëri.</p> <p>Në ligjin aktual nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, neni 34 pika 2, një gjë e tillë është e</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Refuzuar	Lidhur me reflektimin e komentit për OKSHB e licencuara në një vend të BE duke qenë se neni 9 përmban reflektimin e njohjes së produkteve të huaja nuk shihet e nevojshme të reflektohet edhe këtu pasi është përcaktuar njëherë



	<p>parashikuar. Në projektligj nuk gjendet dhe kjo dukshëm përbën regres në krahasim me ligjin aktual. Kërkojmë që të rikthehet ky përcaktim si një nga pikat me kryesore dhe me të rëndësishme.</p> <p>Duke patur parasysh bankat që janë pjese e një Grupi në Bashkimin Evropian dhe në kuadër të ngjarjeve të shumta kibernetike të muajve të fundit, është me shume rëndësi një parashikim i tillë siç edhe është aktualisht në legjislacionin ekzistues. Kjo edhe për të zvogëluar rrezikun e “one-point of failure”.</p>			
<p><b>VI. Vlefshmëria ligjore e identifikimit elektronik të sigurt</b></p>	<p><u>Pika 2 e nenit 5</u> të projektligjit “Vlefshmëria ligjore e identifikimit elektronik të sigurt”</p> <p>Propozojmë që pika 2 të riformulohet si në vijim: “Të dhënat personale të krijuara nëpërmjet identifikimit elektronik të sigurt, kanë të njëjtën vlerë ligjore me të dhënat e përfituara nga identifikimi i një personi fizik nëpërmjet dokumentit zyrtar të identifikimit”.</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Është bërë riformulimi i kësaj pike në përputhje me parashikimet e udhëzimit nr.6/2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”: “2. Të dhënat personale të krijuara nëpërmjet identifikimit elektronik të sigurt, merren të mirëqena dhe të vërteta si dhe kanë të njëjtën vlerë ligjore me të dhënat e përfituara nga identifikimi i një personi fizik nëpërmjet dokumentit zyrtar të identifikimit.”</p>

				Përmbajtja është e njëjtë.
<b>VII. Nënshkrimet elektronike</b>	<p><u>Neni 3:</u> Për dy llojet e nënshkrimeve (Nënshkrim elektronik, Nënshkrimet elektronike të kualifikuara), nga përmbajtja e ligjit kuptohet se për të përfituar nga shërbimet bankare, shtetasit (klientët) duhet të zotërojnë Nënshkrimet elektronike të kualifikuara. Është e paqartë në projekt ligj për grupin tjetër të nënshkrimeve elektronike, në cilat raste mund të përdoren dhe kush i lëshon?</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)	Refuzuar	Nënshkrimet elektronike mund të përdoren në të gjitha shërbimet elektronike por nuk kanë vlerë ligjore pasi njihen vetëm nënshkrimet elektronike të kualifikuara.
	<p>Mungon një parashikim eksplicit për mënyrën dhe domosdoshmërinë e nënshkrimit elektronik të kontratës nga të dyja palët. Kjo mangësi e lë të parregulluar dhe e bën të interpretueshëm si do të nënshkruhet elektronikisht kontrata nga palët. (Një parashikim i tillë për nënshkrimin elektronik, mënyrën e nënshkrimit elektronik të kontratës nga palët ekziston në ligjin nr.9880 “Për nënshkrimin elektronik”, Neni 5 Nënshkrimi elektronik i kualifikuar i kontratës – “Nëse veprimi juridik është një kontratë, atëherë secila prej palëve duhet të nënshkruajë të njëjtin dokument me</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Refuzuar	Lidhur me kontratën nuk shihet e nevojshme përcaktimi në ligj, pasi ligji lejon kryerjen e veprimeve juridike nëpërmjet përdorimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara. Duke qenë se kontrata është një veprim juridik i dyanshëm, pra secila nga palët duhet ta nëshkruaj kontratën si dhe sic është specifikuar në ligj njihet vetëm nënshkrimi elektronik i kualifikuar.

nënshkrimet elektronike të kualifikuara përkatëse”			
<u>Pika 1, e nenit 24</u> të riformulohet si vijon: “Nënshkrimi elektronik i kualifikuar sjell pasoja ligjore dhe pranohet si provë në një procedurë administrative, gjatë hetimit të një çështjeje penale, gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore civile, penale ose administrative, sipas parashikimeve të legjislacionit procedural në fuqi ose gjatë shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese, pavarësisht se pretendimeve për të kundërtën bazuar vetëm në faktin se nënshkrimi është në formë elektronike.”. I njëjti formulim të përdoret edhe për vlefshmërinë e vulave elektronike, vulave kohore elektronike, si dhe të shërbimeve elektronike të kualifikuara të regjistruara. Në pikën 3, të hiqet fjala “vlerësohet”.	MD	Pranuar pjesërisht	Për pikën 1: Përcaktimi i bërë në është i qartë dhe në përputhje me parashikimet e Rregullores eIDAS.  Pika 3, <i>vlerësohet</i> , është hequr
<u>Në pikën 1 të nenit 24</u> përmendet nënshkrimi elektronik i kualifikuar, ndërsa në pikat 2 dhe 3, përmendet nënshkrimi elektronik. Edhe titulli është për nënshkrimet elektronike. Sugjerojmë që të mbahet i njëjti term në të gjithë pikat e këtij neni.	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Pranuar	Reflektuar
<u>Neni 24, pika 2, Kreu V</u>	AKSHI	Pranuar	Reflektuar

	<p>Në nenin 24, të Kreut V, të projekt aktit të propozuar, sugjerojmë të hiqet pika 2, duke qenë se kufizimet e përdorimit të shërbimeve të besuara, ku përfshihet edhe nënshkrimi elektronik, janë parashikuar në nenin 2 të këtij projektligji. Ky kufizim në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike elektronike, nga administrata publike dhe më gjerë, nëpërmjet të cilave ofrohet dhe përfitohet dokumenti elektronik, bëhet pengues për këtë proces.</p>			
	<p><u>Neni 24, pika 2, Kreu V</u>  Dokumenti elektronik dhe nënshkrimi elektronik i kualifikuar i noterit është parashikuar në nenin 95, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe si pasojë, nuk mund të mohohet përdorimi i nënshkrimit elektronik sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 24 të projektligjit. Për më tepër, e gjithë përmbajtja e kësaj pike duhet të rishikohet, në kushtet kur neni 25 i Rregullores së BE-së, nuk ka përcaktuar asnjë kufizim mbi përdorimin e nënshkrimit elektronik ose të jepen sqarimet e nevojshme pse është vendosur ky kufizim.</p>	MD	Pranuar	Reflektuar
	<p><u>Pika 1 e nenit 25 :</u>  Theksojmë se është e nevojshme dhe duhet të</p>	Shoqata Shiptare e	Refuzuar	Neni 25 përcakton përdorimin e nënshkrimeve

	ketë një përcaktim nëse nënshkrimi elektronik i organeve publike duhet të shoqërohet me vulë elektronike, pra duhet të jenë të dy elementët në lidhje me validimin e një dokumenti elektronik.	Bankave (AAB)		elektronike në shërbimet publike, ndërsa në nenin 37 përcaktohet përdorimi i vulave elektronike në shërbimet publike.
<b>VIII. Mbi përcaktimin e tarifave të subjekteve të këtij ligji</b>	<u>Përmbajtja e nenit 49</u> Në nenin 49 pika 1 të projektligjit, në të cilin parashikohet mënyra e përcaktimit të masës dhe llojit të tarifave, mbetet e paqartë mënyra e përdorimit të tyre. Në këto kushte sugjerojnë riformulimin si më poshtë: “Këshilli i Ministrave miraton masën, llojet e tarifave dhe mënyrën e përdorimit të tyre, që personat fizik dhe juridikë, subjekt të këtij ligji duhet ti paguajnë Autoritetit, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.	MFE	Refuzuar	Komenti nuk është reflektuar në projektligj. Për pikën 1 nuk shihet e nevojshme përcaktimi në ligj i “mënyrës së përdorimit të këtyre tarifave” duke qenë se ligji e përcakton qartë se cilat subjekte duhet t’i paguajnë tarifën dhe përse paguhen (regjistrimi, auditimi). Këto tarifa kalojnë në Buxhetin e Shtetit.
	<u>Përmbajtja e nenit 49</u> Në përputhje me komentimin e dhënë në pikën 1.5 (nxjerrja e akteve nënligjore), të rishikohet pika 1, e nenit 49 duke qenë se asnjë dispozitë e projektligjit nuk parashikon pagimin e tarifave për ndonjë nga detyrimet e përcaktuara në ligj. Në këto kushte, të rishikohet në tërësi ligji dhe në ato rastet kur duhet të paguhet tarifë, të parashikohet shprehimisht, detyrimi/shërbimi për të cilin paguhet tarifa.	MD	Refuzuar	Pagesa e tarifave i referohet ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të këtij ligji si OKSHB, OTK, apo organet e certifikimit të pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve/vula ve elektronike, përcaktimi i të cilave do të bëhet me akte nënligjore. Kur një subjekt do të ushtroje veprimtarinë e tij si OKSHB përveç dokumentacionit përkatës që duhet

	Gjatë rishikimit të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 19 të Kodit të Procedurave Administrative mbi parimin e mospagimit në procedurat administrative.			të dorëzoje do të paguaj një tarifë regjistrimi, ashtu edhe sikurse OTK apo organet e certifikimit. Gjithashtu në këto tarifa përfshihen edhe kontrollet periodike të veprimtarisë së OKSHB.
<b>VIII. Autentifikimi i faqeve në internet</b>	<u>Neni 3</u> : Për këto dy certifikata (Certifikatë për autentifikim faqesh internet; Certifikatë e kualifikuar për autentifikim faqesh internet), subjektet të cilat tashme e kanë domain e tyre të regjistruar pranë AKEP, e kanë ende detyrimin që të marrin një nga dy certifikatat e mësipërme, apo quhen automatikisht të certifikuara? Bankat në vend cilën prej dy certifikatave duhet të zotërojnë?	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Refuzuar	Bankat nuk quhen të certifikuara duka pasur domainin e tyre, por duhet të certifikojnë ëebsite e tyre.
	<u>Përmbajtja e nenit 43</u> Projektligji i përcjellë është në përaftrim të plotë me Rregulloren (BE) 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23.07.2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm që shfuqizon direktivën 1999/93 KE” dhe se projektligji në parim/tërësi nuk parashikon dispozita të	AKEP	Pranuar	Reflektuar (neni 43)

	<p>cilat mund të krijojnë mbivendosje apo konflikt me parashikimet ligjore të Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Referuar frymës së bashkëpunimit dhe implementimit rigoroz të projekt aktit pas miratimit të tij gjykojnë të nevojshme zëvendësimin e fjalës “<i>të administruar</i>” në <u>paragrafin ç) të nenit 43</u> të projektligjit me togë fjalëshin “<i>të marrë në përdorim</i>”, për shkak se domainet nën.al administrohen vetëm nga AKEP, i cili i lëshon apo i jep në përdorim me afat të caktuar dhe sipas kërkesës palëve të interesuara (person juridik apo fizik).</p> <p>2. Gjithashtu kanë vlerësuar se në projektligj duhet të parashikohet diferencimi sa i përket autentifikimit të faqeve ëeb nën regjimin e .al dhe nëndomaineve të tij me domainet nën.com etj, pasi në rastin e domaineve nën.al rezulton potencialisht të krijohet një procedurë e dyfishtë autentifikimi ndërmjet shërbimeve të ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe veprimtarisë së AKEP lidhur me</p>			
--	--	--	--	--

	menaxhimin/administrimin e domainit nën “al”.			
<b>IX. Mbi kërkesat e sigurisë për t’u përmbushur nga OKSHB.</b>	<p><u>Përmbajtja e nenit 21</u> Lidhur me parashikimin e bërë në nenin 21 të projektligjit, Zyra e Komisionerit konstaton se në pikën 2 të nenit 19 të Rregullores ( BE) 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 23.07.2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm që shfuqizon direktivën 1999/93 KE” me të cilën ky projektligj përafrohet, parashikohet detyrimi për ofruesit e shërbimeve të besuara të kualifikuara ose jo, që në rastet e shkeljes së sigurisë apo humbje të integritetit që cenon të dhënat personale, të njoftojë edhe autoritetin e të dhënave personale. Ky është një detyrim që shkon në të njëjtën linjë edhe me përcaktimet e kuadrit rregullator evropian të mbrojtjes së të dhënave (konkretisht nenin 33 të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/GDPR) dhe së shpejti do të përfshihet edhe në legjislacionin vendas i cili është në proces përafrimi të plotë me këtë Rregullore. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se pas pikës 3 të këtij</p>	KDIMDHP	Pranuar	Lidhur me komentimin për shtimin pas pikës 3, për të mos pasur përsëritje të paragrafëve është bërë riformulim vetëm i pikës 3 duke qenë se parashikojnë të njëjtën gjë.



	<p>neni duhet të përfshihet një pikë me këtë përmbajtje: “Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar në rastet e shkeljes së sigurisë apo humbje të integritetit që kanë ndikim të rëndësishëm në të dhënat personale duhet të respektojnë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale për të njoftuar autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.”</p>			
	<p><u>Përmbajtja e nenit 21</u> Në pikën 2, të nenit 21, të parashikohet që Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimeve të Besuara të njoftojë edhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucioni përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, në pikën 4, të po të njëjtit nen, përpara fjalëve “shkelja e sigurisë” të shtohen fjalët “publikimi i informacionit mbi shkeljen e sigurisë”.</p>	MD	Pranuar pjesërisht	Lidhur me komentin e bërë për përcaktimin e autoritetit/institucionit përgjegjës për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale është bërë reflektimi i ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Lidhur me pikën është reflektuar.
	<p><u>Neni 20, Pika 2:</u> Autoriteti do të informojë publikun ose i kërkon ofruesit të shërbimit të besuar për ta bërë këtë, kur vendos se shkelja e sigurisë ose humbja e integritetit është në interes të publikut.</p>	VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON	Refuzuar	Referenca është <u>neni 21/4</u> “Autoriteti informon publikun ose i kërkon Ofruesit të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar për ta bërë këtë, kur vendos se shkelja e sigurisë

	<p>Koment: Lutemi të ri-saktësohet: Shkelja është në interes të publikut apo njoftimi?</p>			<p>ose humbja e integritetit është në interes të publikut.” Njoftimi do të bëhet kur shkelja e sigurisë apo humbja e integritetit është në interes të publikut. Pra në rastin kur kemi një ndikim të rëndësishëm tek të dhënat personale apo në shërbimet e besuara të ofruara prej tyre të cilat prekin publikun ky i fundit do të informohet.</p>
	<p>a) <u>Neni 21 pika 2</u> e projektligjit: Në pikën 2, është përcaktuar një afat 24 orë për të lajmëruar Autoritetin, për çdo shkelje të sigurisë apo humbje të integritetit që kanë një ndikim të rëndësishëm tek të dhënat personale apo në shërbimet e besuara të ofruara prej tyre. Propozojmë që nëse ndodhë një incident i tillë, ofruesit e shërbimit duhet të njoftojnë autoritetin brenda 2 orëve, ashtu siç kanë detyrim sistemet kritike për të lajmëruar në rast një incidenti</p> <p>b) <u>Pika 3 e nenit 21</u> të projektligjit: Çfarë afati kohor nënkupton "pa vonesë"? Si përkthehet /interpretohet kjo në numër ditësh që nga momenti që konstatohet impakti negativ që ka patur shkelja e sigurisë</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Riformuluar duke bërë referencë në <i>përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike.</i></p>

	tek një person fizik apo juridik ?			
<b>X. Mbi inspektimin e OKSHB</b>	<p><u>Neni 18</u> Përmbajtja e nenit 18 të riformulohet si vijon: “Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara dhe personat e kontraktuar prej tyre për kryerjen e veprimtarisë, inspektohen nga Autoriteti në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”</p>	MD	Pranuar pjesërisht	Është bërë riformulimi vetëm i pikës 1 duke bërë referimin edhe në legjislacionin përkatës për inspektimet në Republikën e Shqipërisë. Pikat e tjera të nenit janë të qarta dhe janë lënë.
	<p><u>Neni 18- Inspektimi dhe bashkëpunimi</u> Neni 18, pika 1 e projektligjit parashikon se “<i>Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara dhe personat e tretë, që punojnë për ta, lejojnë në çdo kohë personat, të cilët veprojnë në emër dhe me autorizim të Autoritetit, të hyjnë në mjediset dhe laboratorët e tyre gjatë orarit normal të punës edhe pa paralajmërim për të inspektuar veprimtarinë e Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara.</i>”  Parashikimet e këtij ligji janë jo proporcionale dhe potencialisht mund të cenojnë veprimtarinë e përditshme të Ofruesit të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, por edhe personat e tretë që punojnë për ta, por</p>	PAYSERA	Pranuar	Reflektuar komenti. Riformulim i pikes 1 të nenit duke referuar në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”

	<p>edhe parimin e sigurisë juridike. Inspektimi në çdo kohë dhe pa paralajmërim lë shteg për abuzim dhe bisedh me parimet e Kodit të Procedurave Administrative. Bazuar në sa më lart, propozojmë që inspektimet duhet të bëhen me dërgimin e një njoftimi paraprak duke i lejuar Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara të përgatisë informacioni dhe dokumentacionin përkatës, që mund të kërkohet.</p>			
<p><b>XI. Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së OKSHB</b></p>	<p><u>Në nenin 18 pika 1:</u> Ofruesi i shërbimit të besuar i cili nuk ka marrë statusin “i kualifikuar” dhe që synon të ofrojë shërbime të besuara të kualifikuara, menjëherë me fillimin e ushtrimit të aktivitetit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit një kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe raportin e vlerësimit të konformitetit të lëshuar nga Organizmi I Testimit dhe Konfirmimit. Koment: Sugjerojmë të ketë një riformulim, pasi ka një paqartësi – kërkesa duket sikur mund të bëhet në një moment çfarëdo kur Ofruesi i Shërbimit të Besuar të dojë të bëhet i kualifikuar.</p>	<p>VELOXPA Y SHPK  IUTE CREDIT SH.A  RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p><u>Referenca e saktë neni 19.</u> Në versionin e projektligjit të nxjerrë për konsultim publikë kjo pike është formuluar në këtë mënyrë: “Ofruesi i shërbimit të besuar i cili nuk ka marrë statusin “i kualifikuar” dhe që synon të ofrojë shërbime të besuara të kualifikuara, brenda 24 orëve me fillimin e ushtrimit të aktivitetit, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe raportin e vlerësimit të konformitetit të</p>

				lëshuar nga Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit.” Ka afat të vendosur.
<u>Neni 18, Pika 2 b)</u> Zotëron garancinë e nevojshme financiare për dëmshpërblimet e mundshme, sipas Nenet 45 të këtij ligji. Koment: Lutemi vini re se duhet kryer një saktësim pasi Neni 45 i Projekt-Ligjit nuk parashikon garanci financiare.	VELOXPA Y SHPK  IUTE CREDIT SH.A  RUBICON	Refuzuar		<u>Referenca e saktë neni 19/2/b</u> i cili referon tek neni 46 “Garancitë pasurore” si dhe duke qenë se përfshihen tek kriteret që duhet të përmbushë një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar për të ushtruar veprimtarinë e tij do përcaktohet me akt nënligjor (neni 19 pika 8).
<u>Neni 18, Pika 5:</u> Nëse verifikimi nga Autoriteti nuk është përfunduar brenda tre muajve nga marrja e kërkesës nga ofruesi i shërbimit të besuar, Autoriteti informon ofruesin e shërbimit të besuar mbi arsyet për vonesën dhe periudhën brenda së cilës do të përfundojë verifikimi. Koment: Sugjerojmë të vendoset një afat kohor në lidhje me përfundimin e verifikimit.	VELOXPA Y SHPK  IUTE CREDIT SH.A  RUBICON	Pranuar		Referenca e Saktë <u>neni 19/5:</u> Është bërë riformulimi i kësaj pike : “Nëse verifikimi nga Autoriteti nuk është përfunduar brenda 3 (tre) muajve nga marrja e kërkesës nga Ofruesi i shërbimit të besuar, Autoriteti informon Ofruesin e Shërbimit të Besuar mbi arsyet për vonesën dhe periudhën brenda së cilës do të përfundojë verifikimi, e cila nuk mund të kalojë 6 muaj”
<u>Neni 46</u> Garanci financiare të Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimi të Besuar,	MD	Refuzuar		Garancia financiare do parashikohet ne akte nënligjore. Në

	<p>përbëjnë shkak që Autoriteti të ndërpresë veprimtarinë e për shkak se nuk zotërojnë garancitë e nevojshme financiare, kusht për marrjen e statusit “të kualifikuar”, si dhe një nga kërkesat sipas nenit 20. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zotërimit të garancive të duhura financiare, në nenin 46, të parashikohet se cilat janë format ose llojet e garancive financiare, si dhe kriteret për të përcaktuar nëse një ofrues ka ndërmarrë ose jo masat e duhura financiare.</p>			<p>nenin 19 pika 8 përcaktohet se kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushë një OKSHB do përcaktohen me VKM, domethënë kriteret qofshin këto ligjore, financiare (përfshirë garancinë financiare siç është specifikuar në projektligj) e me radhe do përcaktohen me akt nënligjorë.</p>
	<p><u>Neni 45</u>: Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, është i detyruar të marrë masat e duhura financiare, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore për shpërblimin e dëmit sipas parashikimeve në nenin 46. Koment: Propozojmë të ri-kontrollohet pasi Neni 46 nuk përmban parashikime për shpërblimin e dëmit.</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Referenca është <u>neni 46</u> i projektligjit i cili referon tek neni 45 “Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, është i detyruar të marrë masat e duhura financiare, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore për shpërblimin e dëmit sipas parashikimeve në nenin 45, të këtij ligji.</p>
<p><b>XII.</b> <b>Përgjegjësia dhe barra e provës</b></p>	<p><u>Neni 45</u>, Neni 45 të rishikohet në përputhje me</p>	<p>MD</p>	<p>Refuzuar</p>	<p><u>Neni 45</u> “përgjegjësia dhe barra e provës” – Neni 11 i rregullores nuk aplikohet plotësisht pasi ka lidhje me transaksionet</p>

	parashikimet e nenit 11 dhe 13 të Rregullores.			ndërkufitare, gjë e cila nuk është parashikuar në legjislacioni tonë, pra është një nen që aplikohet për vendet e Bashkimit Evropian. Kështu që neni 11 dhe 13 i rregullores është përfshirë në një të vetëm që është neni 45 i ligjit tonë. Gjithashtu ky shpjegim është reflektuar edhe në tabelën e përputhshmërisë.
<b>XIV. Kundravajtjet administrative</b>	<u>Neni 50</u> Sipas parashikimeve të nenit 50, përcaktohen masa të njëjta gjobe për të gjitha kundërvajtjet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, pavarësisht se dispozitat/detyrimi i shkelur dhe pasojat që sjell shkelja nuk janë të njëjta. Në përputhje nenin 16 të Rregullores, i cili parashikon se gjobat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe që kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve, neni 50 të rishikohet në tërësi duke përcaktuar masën e gjobës në kufij minimalë ose maksimalë duke zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ose të përcaktohet masa e gjobës në mënyrë të veçantë për secilën shkelje, në raport me rëndësinë e shkeljes,	MD	Refuzuar	Gjobat e vendosura ndahen në 2 milion lekë për shkeljet në pikën e parë dhe 1 milion lekë për shkeljet në pikën e dytë. Ndarja është bërë duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljes.

	dispozitat e shkelura, raportin e shkeljeve me njëra – tjetrën, pasojat që mund të sjellë shkelja, etj.			
<b>XV. Garancia e skemës së identifikimit elektronik</b>	<p><u>Neni 6</u>: Skema e identifikimit elektronik siguron shkallë të lartë besueshmërie për identitetin e pretenduar apo të pohuar të personit dhe karakterizohet nga specifikime teknike, standarde dhe procedura të lidhura me to, përfshirë këtu kontrole teknike, qëllimi i të cilave është të ulin riskun e keqpërdorimit apo të ndryshimit të identitetit. Komenti: Rregullorja 910/2014 parashikon disa nivele sigurie për skemat e identifikimit elektronik: loë, substantial dhe high, ndërkohë që ligji duket sikur kufizohet vetëm në identifikimin elektronik të sigurt nga ofrues të kualifikuar të shërbimit të besuar. Propozojmë të rishikohet formulimi i pikës.</p>	VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON	Refuzuar	Ligji përcakton nivelin me të lartë të sigurisë së skemës së identifikimit elektronik. Neni 6 pika 1 përcakton “Skema e identifikimit elektronik siguron shkallë të lartë besueshmërie për identitetin e pretenduar apo të pohuar të personit...”, pra në ligj përcaktohet dhe garantohet vetë niveli më i lartë i sigurisë për skemat e identifikimit elektronik.
	<p><u>Neni 6</u>: Specifikimet teknike, standardet dhe procedurat për nivelet e garancisë së besueshmërisë së identifikimit elektronik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Komenti: Në përputhje me Direktivat e BE,</p>	VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON	Refuzuar	Ligji është në përputhje me legjislacionin e BE, vetë Rregulloren eIDAS. Gjithashtu sqarojmë se Autoriteti funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij ndjek të gjitha



	<p>propozojmë riformulim të pikës si në vijim:  “Specifikimet teknike, standardet dhe procedurat për nivelet e garancisë së besueshmërisë së identifikimit elektronik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose sipas standardeve të Bashkimit Evropian.”</p>			<p>standardet dhe ndryshimet më të fundit të bëra në legjislacionin evropian të fushës së identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Prandaj nuk është e nevojshme të specifikohen në ligj.</p>
	<p><u>Neni 6 pika 2 e projektligjit “Garancia e skemës së identifikimit elektronik”</u>  Për të konfirmuar njohjen e Ofruesve të akredituar në BE dhe standardeve të BE, propozojmë që pika e mësipërme të riformulohet si vijon:  “Specifikimet teknike, standardet dhe procedurat për nivelet e garancisë së besueshmërisë së identifikimit elektronik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.”</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Ligji është në përputhje me legjislacionin e BE, vetë Rregulloren eIDAS. Gjithashtu sqarojmë se Autoriteti funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij ndjek të gjitha standardet dhe ndryshimet më të fundit të bëra në legjislacionin evropian të fushës së identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Prandaj nuk është e nevojshme të specifikohen në ligj.</p>
<p><b>XVI. Mbi kushtet dhe procedurën për identifikimin fillestar</b></p>	<p><u>Pika 1 e nenit 8 të projektligjit “Kushtet dhe procedura për identifikimin fillestar”</u>  1)A mundet ofruesi i kualifikuar të transferojë identifikimin fillestar të klientit që do ti lëshohet certifikata elektronike, njësisive të tjera si p.sh bankave? Në rastin kur</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Lidhur me pikën 1:  Referenca në pikën 2, nenin 17, autoriteti regjistruar i OKSHB-së.  Lidhur me pikën 2) referenca është bërë në nenin 9 ku njohet ofruesit të cilët operojnë në</p>

	<p>certifikata kërkohet për të firmosur dokumente bankare dhe jo vetëm sipas ligjit në fuqi, mundet ofruesi i kualifikuar të besoj në identifikimin që kryen Banka për klientët e saj? Konkretisht bankat janë institucione që kryejnë një analizë rigoroze dhe të detajuar për njohjen dhe identifikimin e klientëve të tyre në përputhje të plotë me rregulloren “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”. A mundet të kryejë banka identifikimin fillestar vetëm për klientët e saj në rastin kur shërbimi i firmosjes elektronike për dokumente bankare kërkohet nga klienti, Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve mund të lëshojnë certifikatën duke besuar në identifikimin e kryer nga banka për klientët e Bankës?</p> <p>2) Ky nen nuk parashikon apo nuk jep referencë sesi Autoriteti do ta ndërtojë këtë listë, dhe si do të trajtohen Ofruesit e akredituar në BE.</p>			<p>vendet e BE, ku kuptohet që janë pjesë e listës së besuar evropiane. Gjithashtu referuar mbajtjes së kësaj liste në nenin 15 pika 2 përcaktohet se: “2. Autoriteti krijon, ruan dhe publikon, në mënyrë të sigurt, listën e besuar të nënshkruar apo të vulosur elektronikisht dhe e publikon atë në faqen zyrtare të tij, sipas përcaktimeve të standardeve të Bashkimit Evropian.”</p>
<p>Referuar komentit të bërë në <u>nenin 8, pika 1</u>, më lart, a do të thotë ky parashikim që ofruesi i shërbimit elektronik bashkëpunon me bankën në rastin</p>		<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Referenca në nenin 17 pika 2, autoriteti regjistruar i OKSHB. Bashkëpunimi përcaktohet me</p>

	<p>konkret për identifikimin e klientëve të saj? Dhe nëse po, mendojmë se duhen parashikuar në ligj kriteret dhe kushtet mbi të cilat mund të kryhet ky bashkëpunim.</p>			<p>akte nënligjore tek ushtrimi i veprimtarisë së OKSHB.</p>
	<p><u>Neni 8, Pika 3:</u> Në rastet kur Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar nuk është në gjendje të verifikojë identitetin fizik të kërkuarit, vërtetimi i identitetit kryhet nga organi kompetent që ka lëshuar dokumentin e identifikimit. Koment: Propozojmë të saktësohet si pikë, pasi ka një paqartësi; duket sikur kjo pikë përjashton mundësinë e identifikimit fillestar në distancë që duhet të jetë edhe qëllimi kryesor i Projekt-Ligjit.</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Projektligji përcakton se “Identifikimi fillestar bëhet me paraqitjen fizike ose në distancë me metoda të tjera të identifikimit...” pra nuk përjashton asnjë nga metodat.</p>
	<p><u>Neni 8 pika 4:</u> Metodat e tjera të identifikimit sipas pikës 1, do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Komenti: Në përputhje me Direktivat e BE, propozojmë reformulim të pikës si në vijim: “Metodat e tjera të identifikimit sipas pikës 1, do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave ose në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.”</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në nenin 8, pika 1 e projektligjit përcakton: “Identifikimi fillestar bëhet me paraqitjen fizike ose në distancë me metoda të tjera të identifikimit, që garantojnë siguri të njëjtë sikurse paraqitja fizike të konfirmuar nga një Organizëm i Testimit dhe Konfirmimit, sipas <i>standardeve evropiane</i>, për këtë fushë”. Nuk shihet e nevojshme përcaktimi në</p>

				përputhje me standardet evropiane pasi është përcaktuar.
	<p><u>Pika 4 e nenit 8</u>  “Kushtet dhe procedura për identifikim fillestar”  Në çfarë do të konsistojnë këto "metoda të tjera" (të cilat, në gjykimin tonë, mund të jepeshin paraprakisht edhe në një aneks në këtë projekt-ligj).  Propozojmë që pika 4, të riformulohet si më poshtë: "Metodat e tjera të identifikimit fillestar të aplikuesit sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian."</p>	Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)	Refuzuar	<p>Në nenin 8, pika 1 e projektligjit përcakton:  “Identifikimi fillestar bëhet me paraqitjen fizike ose në distancë me metoda të tjera të identifikimit, që garantojnë siguri të njëjtë sikurse paraqitja fizike të konfirmuar nga një Organizëm i Testimit dhe Konfirmimit, sipas standardeve evropiane, për këtë fushë”. Nuk shihet e nevojshme përcaktimi në përputhje me standardet evropiane pasi është përcaktuar. Gjithashtu lidhur me afatin e nxjerrjes së këtyre akteve nënligjore në ligj është përcaktuar afati 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pasi janë disa akte që duhet të nxirren dhe nevojitet koha e nevojshme për nxjerrjen e tyre.</p>
<b>XVII. Njohja e Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në</b>	<p><u>Neni 9, Pika 1:</u>  Skemat e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara, njihen dhe zbatohen në përputhje me</p>	VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A	Refuzuar	<p>Riformuluar si nen “Njohja reciproke dhe njohja e produkteve të huaja”. Gjithashtu referuar nenit 5 të</p>

<p><b>vendet e Bashkimit Evropian ( Neni 9 )</b></p>	<p>aktmarrëveshjet e lidhura nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaja, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave.</p> <p>Koment: Neni 9 (propozojmë heqjen e pikës 1, Neni 9) Në përputhje me Nenin 5, të direktivës Numër 910/2014 të Bashkimit Evropian, shkëmbimi i të dhënave kryhet në referencë me direktivën 95/46/EC dhe jo bazuar në kontrata.</p> <p>Propozojmë heqjen e pikës 1 të Nenit 9 nga Projekt-Ligji.</p>	<p>RUBICON</p>		<p>Rregullores përcaktohet parimi i mbrojtjes së të dhënave personale, parim i cili është reflektuar në këtë ligj, në nenin 4. Pika 1 është riformuluar duke referuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në rastin e shkëmbimit dhe pranimin të të dhënave</p>
	<p><u>Neni 9, pika 1</u> e projektligjit parashikon se “skemat e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara, njihen dhe zbatohen në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaj, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave.”</p> <p>Ky parashikim shënon një kthim mbrapa në raport me regjimin ekzistues deri më tani. Më saktësisht, neni 34 i Ligjit 107/2015 parashikon se “Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet e Bashkimit Evropian dhe janë akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe</p>	<p>PAYSERA</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Ky nen është riformuluar “Njohja reciproke dhe njohja e produkteve të huaja” Gjithashtu është shtuar pas pikës 1 pika 2 me përmbajtje: “Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të akredituar nga Autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre, kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një</p>

	<p>shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.”</p> <p>Në relacioni shoqërues të projektligjit, por edhe në projektligj nuk shohim ndonjë arsyetim të ndryshimit të regjimit ekzistues. Duke qenë se vetë projektligji është përafuar plotësisht me Rregulloren 910/2014 të Bashkimit Evropian, propozojmë që edhe neni 9, pika 1 të ruajë regjimin ekzistues dhe Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar të akredituar në vendet e Bashkimit Evropian të njihen automatikisht edhe në Shqipëri.</p>			<p>Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë”</p>
	<p><u>Neni 9 pika 1</u> e projektligjit “Njohja reciproke”</p> <p>Parashikimi i mësipërm është një regres dhe pjesa me shqetësuese lidhur me këtë draft ligj. Mendojmë se është e pakuptimte që një ofrues shërbimi të besuar i certifikuar nga organizma të akredituar sipas rregullores Evropiane “910/2014 e-idas compliant” nuk janë të njohura nga autoriteti lokal, por duhet të trajtohen njëjloj si ofruesit e shërbimeve të besuara që regjistrohen për herë</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Riformuluar si nen “Njohja reciproke dhe njohja e produkteve të huaja” duke përfshirë edhe OKSHB e akredituara në një nga vendet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu lidhur me heqjen e pikes 1: referuar nenit 5 të Rregullores përcaktohet parimi i mbrojtjes së të dhënave personale, parim i cili është reflektuar në këtë ligj, në nenin 4.</p>

	<p>të parë, pavarësisht se në draft ligj merren si reference standardet evropianë për ofruesit e shërbimeve të besuara. Kërkesa për marrëveshje dypalëshe me shtetet e huaja nuk ka kuptim, dhe nuk sjell asnjë vlerë kur vetë Direktiva 910/2014 e BE citon që shkëmbimi i të dhënave kryhet në referencë me direktivën 95/46/EC dhe jo bazuar në kontrata /forma të tjera, ndaj kërkohet heqjen e kësaj pike dhe shtimin e pikës 3 si më poshtë propozuar. Në nenin 9, propozojmë të shtohet një pikë 3, me përmbajtje si vijon: “Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar të cilët operojnë në vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese si ato të lëshuara nga një Ofrues që operon në Republikën e Shqipërisë.”</p>			Pika e parë është riformuluar duke referuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
	Propozojmë gjithashtu të jetë e përfshirë mundësia për ofrues shërbimi të licensuar në BE sa kemi propozuar dhe në projektligj.	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Pranuar	Njohja e OKSHB që operojnë në vendet e BE-së. Reflektuar në nenin 9 të ligjit.
<b>XVIII. Lista e besuar</b>	<u>Neni 14</u>	VELOXPA Y SHPK	Pranuar	Ky koment është reflektuar në nenin

	<p>Autoriteti krijon, mirëmban dhe publikon listën e besuar, që përfshin informacion në lidhje me Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, si dhe informacion mbi shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara prej tyre, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti krijon, ruan dhe publikon, në mënyrë të sigurt, listën e besuar të nënshkruar apo të vulosur elektronikisht, në një formë të përshtatshme për përpunim automatik, sipas përcaktimeve të standardeve të BE-së. Komenti: Sugjerojmë që edhe ofruesit në vendet e Bashkimit Evropian të lejohen të operojnë në Shqipëri, ndoshta [pas një procesi regjistrimi në Shqipëri (jo ri-licensimi)]. Kjo garanton edhe ruajtjen e standardeve të BE, por edhe eviton bllokimin e operimit në mungesë të operatorëve të licencuar vendas, duke qenë para faktit se Institucionet e Parasë Elektronike dhe ato IFJB, si edhe disa prej Bankave, tashmë operojnë me operatorë të tillë.</p> <p>Propozojmë shtimin e pikës 3, sipas Nenit 34 të ndryshuar nga Ligji i mëparshëm, si në vijim: “Për Ofruesit e Kualifikuar të</p>	<p>IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>		<p>9 të këtij ligji ku njihen edhe ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar që operojnë në vendet e Bashkimit Evropian, pjesë e listës së besuar evropiane (EU trusted list)</p>
--	---	--	--	---



	<p>Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vende anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.”</p>			
	<p><u>Neni 14 i projektligjit:</u> Ne këtë nen përmendet regjistri i Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Ndërkohe tek neni 3 (përkufizimet) gjenden edhe Ofruesit e Shërbimit të Besuar. Duhet të ketë një listë të publikuar nga Autoriteti edhe për Ofruesit e Shërbimit të Besuar.</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Ligji përcakton vetëm Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Tek përkufizimet janë përmendur në përputhje me rregulloren eIDAS, duke bërë dallimin midis tyre.</p>
	<p><u>Pika 1 e nenit 15 të projektligjit:</u> Po në rastet kur Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre a do të njihen? A do të duhet që edhe këto entitete të certifikohen edhe nga AKCESK përpara se të operojnë edhe në Republikën e Shqipërisë?</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Neni 9 është riformuluar duke njohur edhe ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara që operojnë në vendet e BE-së të cilët kuptohet që janë pjesë e <i>EU trusted list</i>. Nuk është e nevojshme mbajtja e një liste të tillë nga ne.</p>

	<p>Propozojmë që pika e mësipërme të riformulohet si vijon:  “Autoriteti krijon, mirëmban dhe publikon listën e besuar, që përfshin informacion në lidhje me Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, si dhe informacion mbi shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara prej tyre, qe ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë ose të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës.”</p>			
<p><b>XIX. Rastet e ndërprerjes së veprimtarisë së Autoritetit</b></p>	<p><u>Pika 1 e nenit 16 të projektligjit</u>: Në këtë nen përmenden rastet kur Autoriteti ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimi të Besuar. Duhet te ketë edhe sqarim sesi do operohet ne mungese te veprimtarisë, si do lajmërohen marrësit e shërbimit etj. Kjo mund të bëhet si në këtë nen ashtu edhe ne aktet nënligjore përkatëse.</p>	<p>Shoqatës Shqiptare të Bankave ( AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në pikën 2 të projektligjit përcaktohet se rregullat në rast të ndërprerjes së veprimtarisë së Autoritetit do përcaktohen me akte nënligjore, kështu që edhe komenti i bërë përfshihet aty.</p>
	<p><u>Në pikën 1, të nenit 16,</u> fjalët “ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë” lënë vend për disa interpretimi si: ndërprerjen e përkohshme të të gjithë veprimtarisë së ofruesit, ndërprerjen e</p>	<p>MD</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Është bërë riformulimi i pikës 1 të nenit 16. Ndërsa lidhur me pjesën e rasteve të ndërprerjes së veprimtarisë, pika 2 përcakton që rregullat përcaktohen në</p>

	<p>përkohshme të një pjese të veprimtarisë së ofruesit, ndërprerjen e përhershme të të gjithë veprimtarisë së ofruesit ose ndërprerjen e përhershme të një pjese të veprimtarisë së ofruesit. Për efekt të qartësisë së normës, pika 1 të riformulohet për të përcaktuar saktë se cili ose cilat nga rastet e sipërcituara do të zbatohet nga Autoriteti.</p>			<p>rregulloren që miratohen me udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm</p>
<p><b>XX. Mbikëqyrja e veprimtarisë së OKSHB</b></p>	<p><u>Neni 21, Pika 2:</u> Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, Autoriteti në çdo kohë mund të kryejë një auditim ose t'i kërkojë një Organizmi Testimi dhe Konfirmimi për të kryer një vlerësim të konformitetit të Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, me shpenzimet e këtyre të fundit, për të konfirmuar se shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara prej tyre plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Kur rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale shkelen, Autoriteti njofton institucionin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale për rezultatet e kontrollit të tij. Koment: Duhet të ketë dhënie justifikimi me dyshime për shkelje të detyrimeve ligjore nga ana e Ofruesit të Shërbimit?</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Referenca e saktë është neni 22 pika 2 “Pa cenuar pike 1 të këtij neni, Autoriteti në çdo kohë mund të kryejë një auditim ose t'i kërkojë një Organizmi Testimi dhe Konfirmimi për të kryer një vlerësim të konformitetit të Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, me shpenzimet e këtyre të fundit, për të konfirmuar se shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara prej tyre plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Kur shkelen rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, Autoriteti njofton institucionin përgjegjës për mbrojtjen e të</p>

				<p>dhënave personale për rezultatet e kontrollit të tij.”</p> <p>Termi auditim është zvendësuar me “kontroll”.</p> <p>Kjo dispozitë ka për qëllim qenien konform parashikimeve të këtij projektligji lidhur me veprimtarinë e Ofruesit të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar. Si rregull Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, auditohen me shpenzimet e tyre, të paktën çdo 24 muaj, si dhe për çdo ndryshim të mundshëm në procesin e ofrimit të shërbimit, nga Organizmi i Testimit dhe Konfirmimit. Pika 2 i referohet rasteve për të konfirmuar se veprimtaria dhe shërbimet që ofruesi ofron janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj. Nga verifikimet e bëra lind edhe e drejta e Autoritetit për të kryer auditim në çdo kohë apo ti kërkojë një Organizmi Testimi dhe Konfirmimi për të</p>
--	--	--	--	--

				bërë vlerësimin e konformitetit.
<b>XXI.Pajisjet për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara</b>	<p><u>Neni 27, Pika 1;</u> Përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në nenin 26 të pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, do të certifikohet nga një organ publik ose privat (organ certifikimi i pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara), i akredituar nga Autoriteti Përgjegjës për Akreditimin në Republikën e Shqipërisë. Koment: Në përgjithësi ky ligj kërkon krijimin/licencimin e disa organizmave të cilat do të kërkojnë kohë të licensohen/krijohen dhe kjo gjë në vend që të zhvillojë këtë sektor, mund ta pengojë apo bllokojë më tej. Ndaj është e nevojshme që të thjeshtohet sistemi nga njëra anë dhe nga ana tjetër të lejohet operimi në Shqipëri i operatorëve të listës të BE- së të cilët certifikohen/akreditohe n nga organizma të BE- së, pra paraqesin atë shkallë besueshmërie që synohet të arrihet edhe në Shqipëri. Autoriteti Përgjegjës për Akreditimin në Republikën e Shqipërisë: Cili është</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Referenca është neni 28/1 I projektligjit. Marrë në konsideratë komentet e ardhura edhe nga institucionet e tjera ky nen është riformuluar ku përcaktohet se përputhshmëria me kërkesat e këtij ligji do të bëhet nga një organ i certifikimit të këtyre pajisjeve vendas ose ndërkombëtarë i akredituar në një nga vendet e Bashkimit Evropian.</p>

	<p>ky Autoritet? Në bazë të ligjit 116/2014, Neni 5: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues; b) organe certifikuese të sistemeve të menaxhimit; c) organe certifikuese të personelit; ç) organe certifikuese të produkteve ; d) organe inspektuese; dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike; e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara. Nuk duket sikur akreditimi i organeve të certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike është në fushën e kompetencës së DPA.</p>			
	<p><u>Neni 27, Pika 4 b)</u> Certifikimi i pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, referuar në pikën 1, do të bazohet: në një proces vlerësimi të sigurisë i kryer në përputhje me një nga standardet për vlerësimin e sigurisë së produkteve të teknologjisë së informacionit, të përfshira në listën e përcaktuar në paragrafin e dytë të kësaj pike.</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Referenca është <u>neni 28 pika 4</u>: “Certifikimi i pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, referuar në pikën 1, të këtij neni bazohet: a) në një proces vlerësimi të sigurisë i kryer në përputhje me një nga standardet për vlerësimin e sigurisë së</p>

	Koment: Lutemi të përcaktohet lista, pasi nuk ka listë referuese sipas paragrafit 2 të pikës.			produkteve të teknologjisë së informacionit, të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga Autoriteti; ose b) në një proces tjetër përveç procesit të referuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, me kusht që të përdorë nivele të barasvlershme të sigurisë dhe t’i njoftohet Autoritetit nga organi i certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara. Ky proces mund të përdoret vetëm në mungesë të standardeve të referuara në shkronjën “a”, të kësaj pike ose kur një proces i vlerësimit të sigurisë të referuar në shkronjën “a” është në proces.
<b>XXII. Dokumenti elektronik</b>	<u>Neni 3, Pika 9:</u> “Dokument elektronik” është çdo material i ruajtur në formë elektronike, në veçanti tekst apo regjistrim audio, vizual apo audio-	VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON	Refuzuar	Është bërë riformulimi I përkufizimit: “Dokument elektronik” është çdo material i krijuar, i dërguar, i marrë, i transmetuar ose i ruajtur në formë

	<p>vizual, që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligji;  <i>Komenti: Ky ligj për se nuk përcakton kriteret për dokumentin elektronik.</i></p>			<p>elektronike, në veçanti tekst apo regjistrim audio, vizual apo audio-vizual, që plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin nr.10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, I ndryshuar Lidhur me përcaktimin e kriterëve nuk mund të bëhet në këtë ligj duke qenë se janë të përcaktuara në ligjin nr.10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar, I cili nuk është shfuqizuar.</p>
	<p><u>Neni 44</u> : Një dokument elektronik konsiderohet i pranueshëm në procedurat ligjore, pavarësisht se është në formë elektronike.</p> <p>Koment: Gjykojmë se ky term është një përkufizim shumë i gjerë që mund të keqinterpretohet. Ndërkohë, Rregullorja 910/2014 parashikon se “dokumenti elektronik nuk do të refuzohet në procedurat ligjore vetëm për faktin që është elektronik” që nënkupton se në çdo rast dokumenti elektronik duhet të plotësojë kushte të caktuara për t’u pranuar</p>	<p>VELOXPA Y SHPK IUTE CREDIT SH. A RUBICON</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Parashikimi i bërë më sipër nënkupton që dokumenti elektronik ka vlefshmëri të njëjtë ligjore dhe provuese si ai në letër. Gjithashtu njohja dhe përdorimi i dokumentit elektronik gjen rregullim në ligjin nr. 10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar, i cili nuk është shfuqizuar. Për këtë pike është bërë riformulimi “Një dokument elektronik</p>



	<p>në varësi të procedurës. Gjithashtu, Neni 2.3 i rregullores së BE parashikon se “Rregullorja nuk do të çënojë ligjin e brendshëm lidhur me lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratave ose detyrimeve të tjera proceduriale apo ligjore lidhur me formën” dhe ky parashikim nuk është përfshirë në këtë draft ligj ku duket se dokumenti elektronik do të pranohet në çdo formë dhe në çdo procedurë.</p>			<p>konsiderohet i pranueshëm në procedurat ligjore, pavarësisht se është në formë elektronike dhe ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore”</p>
	<p><u>Neni 44 pika 1:</u> Propozojmë që pika 1 e nenit 44 të riformulohet si vijon: “Një dokument elektronik konsiderohet i pranueshëm në procedurat ligjore, pavarësisht se është në formë elektronike dhe ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.”</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave ( AAB)</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Reflektuar</p>
	<p>Mungon përcaktimi se si do të bëhet Vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik, deri me tani kjo procedurë është e rregulluar /parashikuar në ligjin Nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”, respektivisht ne nenin 10 dhe 11, por që me</p>	<p>Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Lidhur me dokumentin elektronik, rregullohet nga ligji nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik" (i përditësuar), i cili nuk është shfuqizuar. Është reflektuar ndryshimi tek përkufizimi i nocionit</p>

	hyrjen ne fuqi të këtij ligji shfuqizohet.			“dokument elektronik” në pikën 9 të nenit 3 të projektligjit, ku është bërë riformulimi i kësaj pike duke referuar në ligjin nr.10273/2010.
<b>XXIII. Mbi përmbajtjen e nenit 11</b>	<u>Neni 11</u> “Aksesi për personat e kufizuar” Përcaktimi që është aktualisht ne projektligj është i përgjithshëm dhe lë vend për t’u interpretuar në praktikë se nga kush caktohet mundësia apo pamundësia e subjekteve për të ofruar shërbime të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Sugjerojmë që në ligj dhe/ose aktet nënligjore të ketë përcaktime /udhëzime me të zgjeruara të lidhura me këtë çështje.	Shoqata Shqiptare e Bankave		Ky formulim është bërë në përputhje me parashikimet e rregullores eIDAS neni 15 i saj. Gjithsesi mund të shihet mundësia e përcaktimit me akte nënligjore , ndoshta tek kriteret/kushtet per OKSHB të perfshihet edhe kjo pike për ofrimin e shërbimeve për këto kategori
<b>XXIV.Vula elektronike</b>	<u>Nenet 33-38 – Vula elektronike.</u> Sugjerojmë të specifikohet qartë për cilën kategori personash lëshohet vule elektronike, edhe pse mund të nënkuptohet që ajo lëshohet për personat juridike.	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Refuzuar	Me vulë elektronike mund të pajiset çdo person fizik ose juridik sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.
<b>XXV. Nxjerrja e akteve nënligjore</b>	Në kushtet kur pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në BE, rregulloret do të jenë drejtpërdrejtë të zbatueshme, si dhe në përputhje me seksionin 6.2 të Pjesës “F”, të Manualit të Hartimit të Legjislacionit,	MD	Refuzuar	Nuk ka dispozita të tilla. Nxjerrja e akteve nënligjore për rregullimet përkatëse është bërë në përputhje me parashikimet e Rregullores. Për më tepër që pas aderimit në BE do

	<p>bashkëlidhur udhëzimit nr.6, datë 29.4.2022, të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, të identifikohen qartë, të gjitha ato dispozita që janë të njëjta me Rregulloren (BE) nr.910/2014 dhe të parashikohet shfuqizimi i tyre në datën e aderimit të RSH në BE.</p>			<p>jenë drejtpërdrejtë të zbatueshme por legjislacioni i BE ( rregulloret) jep mundësinë që në legjislacionin kombëtar të bësh rregullimet përkatëse.</p>
	<p>Në përmbajtje të projektligjit rezulton se ka parashikime të ndryshme mbi nxjerrjen e akteve nënligjore, ku përcaktohet se disa akte nxirren nga Autoriteti dhe disa nga Drejtori i Përgjithshëm i tij. Në përputhje me dispozitat e neneve 116 - 118 të Kushtetutës, të rishikohen këto dispozita duke parashikuar miratimin e akteve nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoriteti. Gjithashtu, të rishikohen në dispozitat autorizuese në mënyrë që të përcaktohen qartë çështjet që do të rregullohen me aktet nënligjore, organi që e nxjerr atë dhe lloji i aktit nënligjor që duhet të miratohet. Sa i përket organit që nxjerr aktin, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 118, për aktet nënligjore me karakter normativ në zbatim të këtij ligji, të</p>	<p>MD</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Reflektuar</p>

	<p>parashikohet miratimi i tyre nga Këshilli i Ministrave ose Kryeministri, si organe të parashikuara nga Kushtetuta.</p>			
	<p><u>Delegimi i kompetencave Këshillit të Ministrave</u>          Projektligji në disa nene të tij autorizon Këshillin e Ministrave për të detajuar rregullat e projektligjit, por edhe për të përcaktuar kriteret dhe procedurat përkatëse. Duke qenë se këto kritere dhe procedura janë të një rëndësie të veçantë dhe mund të krijojnë vakume, gjithashtu nga praktika e mëparshme edhe rregullave të reja, do të sugjeronim që paketa e akteve nënligjore të nxirrej sa më shpejt të jetë e mundur, përpara miratimit të projektligjit nga Kuvendi.</p>	<p>PAYSERA</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve. Neni 118 i Kushtetutës : “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.          2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.          3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”          Gjithashtu duke qenë se janë shumë akte nënligjore duan kohën e duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e tyre. Në dispozitat kalimtare përcaktohet se aktet nënligjore të dala në zbatim të</p>

				ligjit nr.107/2015, i ndryshuar dhe ligjit nr.9880/2008, i ndryshuar , vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore.
	Aktet nënligjore duhet te publikohen dhe të hyjnë ne fuqi te gjitha ne një moment dhe ne një kohe sa me të shkurtër nga hyrja ne fuqi e ligjit te ri, e shumta 3 muaj.	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)	Refuzuar	Afati i përcaktuar është 6 muaj. Duke qenë se janë shumë akte nënligjore duan kohën e duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e tyre. Në dispozitat kalimtare përcaktohet se aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr.107/2015, i ndryshuar dhe ligjit nr.9880/2008, i ndryshuar , vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore.
	A është parashikuar nxjerrja e një VKM-je që të përcaktojë cilat do te jenë organet publike që do të kenë edhe vulë elektronike, pasi kjo lidhet me vlefshmërinë e dokumentit elektronik të lëshuar nga organi publik.	Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)		Pajisja me nënshkrim dhe vulë elektronike është vullnetarë, të gjithë subjektet që duhet të ofrojnë ose marrin dokumente elektronike duhet të pajisen me nënshkrim për ti dhënë dokumentit vlerë ligjore njësoj si një dokument i nënshkruar dorazi.

